



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenit 65 të Ligjit nr. 03/L–209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L–150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10/03 Prill 2017), si dhe në bazë të nenit 21 dhe 136 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 14 maj 2026), nenit 8, nenit 58 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-304 për Bankat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2 / 27 janar 2026) si dhe nenit 114 të Ligjit Nr.04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 11/11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KONTRAKTIMIN E JASHTËM

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kornizën rregullative të brendshme të qeverisjes duke përfshirë menaxhimin e shëndoshë të rrezikut, në lidhje me funksionet e kontraktimit të jashtëm, në veçanti për kontraktimin e jashtëm të funksioneve kritike ose të rëndësishme.
2. Kjo rregullore zbatohet për bankat, institucionet e parasë elektronike, institucionet e pagesave, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (“institucionet”).

Neni 2

Përkufizimet

1. Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të Ligjit Nr.10/L-026 për Shërbimet e Pagesave, nenin 3 të Ligjit Nr. 08/L-304 për bankat, dhe Ligjit për Institucionet mikrofinanciare dhe Institucionet financiare jobankare.
2. Përveç kësaj në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, shprehjet dhe shkurtesat e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - 2.1. **“Kontraktimi i jashtëm (ang. Outsourcing)”** nënkupton një marrëveshje të çdo forme ndërmjet një banke, një institucioni të pagesave ose një institucioni të parasë elektronike dhe një ofruesi të shërbimeve me anë të të cilit ai ofrues i shërbimeve kryen një proces, një shërbim ose një aktivitet që përndryshe do të kryhej nga vetë banka, institucioni i pagesave ose institucioni i parasë elektronike;
 - 2.2. **“Funksion”** nënkupton çdo proces, shërbim ose aktivitet;

- 2.3. **“Funksion kritik ose i rëndësishëm”** nënkupton çdo funksion që konsiderohet kritik ose i rëndësishëm siç përcaktohet në këtë Rregullore;
- 2.4. **“Nën-kontraktimi i jashtëm”** nënkupton një situatë ku ofruesi i shërbimit sipas një marrëveshjeje të kontraktimit të jashtëm transferon më tej një funksion të kontraktuar nga jashtë tek një ofrues tjetër të shërbimeve;
- 2.5. **“Ofruesi i shërbimit”** nënkupton një entitet të palës së tretë që po kryen një proces, shërbim ose aktivitet të kontraktuar nga jashtë, ose pjesë të tyre, sipas një marrëveshjeje të kontraktimit të jashtëm;
- 2.6. **“Shërbimet Cloud”** nënkupton shërbime të ofruara duke përdorur cloud kompjuterët, domethënë një model për të mundësuar qasjen në rrjetin e kudondodhur, të përshtatshëm, sipas kërkesës në një grup të përbashkët burimesh kompjuterike të konfigurueshme (p.sh., rrjete, serverë, memorie, aplikacione dhe shërbime) që mund të ofrohen me shpejtësi dhe lëshohen me përpjekje minimale të menaxhimit ose ndërveprim me ofruesin e shërbimit;
- 2.7. **“Cloud publik”** nënkupton infrastrukturë cloud e disponueshme për përdorim të hapur nga publiku i gjerë.
- 2.8. **“Cloud privat”** nënkupton infrastrukturë cloud e disponueshme për përdorim ekskluziv nga një institucion i vetëm ose institucion i pagesave.
- 2.9. **“Cloud i komunitetit”** nënkupton infrastrukturën cloud të disponueshme për përdorim ekskluziv nga një komunitet specifik institucionesh ose institucioneve të pagesave, duke përfshirë disa institucione të një grupi të vetëm.
- 2.10. **“Cloud hibrid”** nënkupton infrastrukturë cloud që përbëhet nga dy ose më shumë infrastrukture të dallueshme cloud.
- 2.11. **“TIK”** nënkupton teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.
- 2.12. **“Skema e mbrojtjes institucionale”** nënkupton një marrëveshje detyrimi kontraktual ose ligjor që mbron ato institucione që janë anëtare të skemës dhe në veçanti siguron likuiditetin dhe aftësinë paguese të tyre për të shmangur falimentimin kur është e nevojshme.
- 2.13. **“Organ menaxhues”** nënkupton:
 - 2.13.1. për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, kjo shprehje ka të njëjtin kuptim si në nenin 36, të Ligjit nr. 08/L-304 për Bankat, përkatësisht nenin 96 Ligji nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobanake.;
 - 2.13.2. për institucionet e pagesave ose institucionet e parasë elektronike, kjo shprehje nënkupton drejtorët ose personat përgjegjës për menaxhimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike dhe, sipas rastit, personat përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve të shërbimeve të pagesave të institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike;
 - 2.13.3. për OSHP-të e përmendura në nënparagrafët 1.4, 1.5 dhe 1.6 të nenit 1 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave, kjo shprehje ka kuptimin që i jep Ligji për Shërbimet e Pagesave;
- 2.14. **“Institucionet”** nënkupton bankat, institucionet e parasë elektronike, institucionet e pagesave, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare;

- 2.15. **“Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale”** nënkupton Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe/ose Ligjin në fuqi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- 2.16. **“Ligji për bankat”** nënkupton Ligjin nr. 08/L-304 për Bankat dhe/ose Ligjin në fuqi mbi Bankat;
- 2.17. **“Ligji për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare”** nënkupton Ligjin nr. 04/L-093 mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe/ose Ligjin në fuqi mbi IMF dhe IFJB;
- 2.18. **“Ligji për Shërbimet e Pagesave”** nënkupton Ligjin Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.

KAPITULLI II

PROPORCIONALITETI: APLIKIMI NË GRUP DHE SKEMAT E MBROJTJES INSTITUCIONALE

Neni 3

Proporcionaliteti

1. Institucionet dhe BQK duhet të zbatojnë parimin e proporcionalitetit për të siguruar që marrëveshjet e qeverisjes, duke përfshirë ato që lidhen me kontraktimin e jashtëm, janë në përputhje me profilin individual të rrezikut, natyrën dhe modelin e biznesit të institucionit dhe shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të tyre në mënyrë që objektivat e kërkesave rregullore janë arritur në mënyrë efektive.
2. Gjatë zbatimit të kërkesave të përcaktuara në këtë rregullore, institucionet duhet të marrin parasysh kompleksitetin e funksioneve të kontraktuara nga jashtë, rreziqet që rrjedhin nga marrëveshja e kontraktimit të jashtëm, rëndësinë kritike ose rëndësinë e funksionit të kontraktuar nga jashtë dhe ndikimin e mundshëm të kontraktimit të jashtëm në vazhdimësinë e aktiviteteve të tyre.

Neni 4

Kontraktimi i jashtëm nga grupet dhe institucionet që janë anëtarë të një skeme të mbrojtjes institucionale

1. Kjo rregullore duhet të zbatohet gjithashtu në baza të nën konsoliduara dhe të konsoliduara, duke marrë parasysh shtrirjen e kujdesshme të konsolidimit. Për këtë qëllim, ndërmarrjet amë duhet të sigurojnë që rregullat proceset dhe mekanizmat e qeverisjes së brendshme në filialet e tyre, duke përfshirë institucionet e pagesave, të jenë të qëndrueshme, të integruara mirë dhe të përshtatshme për zbatimin efektiv të kësaj rregulloreje në të gjitha nivelet përkatëse.
2. Institucionet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, dhe institucionet që, si anëtarë të një skeme të mbrojtjes institucionale, përdorin rregullat e qeverisjes të ofruara nga qendra, duhet të kenë pajtueshmëri me sa vijon kur ato institucione:
 - 2.1. kanë marrëveshje për kontraktimin e jashtëm me ofruesit e shërbimeve brenda grupit ose skemës së mbrojtjes institucionale, organi menaxhues i këtyre institucioneve bartë, edhe për këto marrëveshje të kontraktimit të jashtëm, përgjegjësinë e plotë për pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat rregullore dhe zbatimin efektiv;

- 2.2. kontraktajnë nga jashtë detyrat operationale të funksioneve të kontrollit të brendshëm të një ofruesi të shërbimeve brenda grupit ose skemës së mbrojtjes institucionale, për monitorimin dhe auditimin e marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm, institucionet duhet të sigurojnë që, edhe për këto marrëveshje të kontraktimit të jashtëm, këto detyra operationale të kryhen në mënyrë efektive, duke përfshirë nëpërmjet marrjes së raporteve të duhura.
3. Përveç paragrafit 2 të këtij neni, institucionet brenda një grupi për të cilat nuk janë dhënë përjashtime, institucionet që janë organ qendror ose që janë të lidhura në mënyrë të përhershme me një organ qendror për të cilin nuk janë dhënë përjashtime, ose institucionet që janë anëtare të një skeme të mbrojtjes institucionale duhet të marrin parasysh sa vijon:
- 3.1. kur monitorimi operacional i kontraktimit të jashtëm është i centralizuar (p.sh., si pjesë e një marrëveshjeje të përgjithshme për monitorimin e marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm), institucionet duhet të sigurojnë që, të paktën për funksione kritike ose të rëndësishme të kontraktuara nga jashtë, si monitorimi i pavarur i ofruesit të shërbimit ashtu edhe mbikëqyrja e duhur nga çdo institucion është i mundur, përfshirë duke marrë, të paktën çdo vit dhe me kërkesë nga funksioni i centralizuar i monitorimit, raportet që përfshijnë, të paktën, një përmbledhje të vlerësimit të rrezikut dhe monitorimit të performancës. Gjithashtu, institucionet duhet të marrin nga funksioni i centralizuar i monitorimit një përmbledhje të raporteve përkatëse të auditimit për kontraktimin e jashtëm kritik ose të rëndësishëm dhe, sipas kërkesës, raportin e plotë të auditimit;
- 3.2. institucionet duhet të sigurojnë që organi i tyre menaxhues do të informohet siç duhet për ndryshimet përkatëse të planifikuara në lidhje me ofruesit e shërbimeve që monitorohen në mënyrë qendrore dhe ndikimin e mundshëm të këtyre ndryshimeve në funksionet kritike ose të rëndësishme të ofruara, duke përfshirë një përmbledhje të analizës së rrezikut, duke përfshirë rreziqet ligjore, pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe ndikimin në nivelet e shërbimit, në mënyrë që ata të vlerësojnë ndikimin e këtyre ndryshimeve;
- 3.3. kur ato institucione brenda grupit, institucionet e lidhura me një organ qendror ose institucionet që janë pjesë e një skeme të mbrojtjes institucionale mbështeten në një vlerësim qendror të para kontraktimit të jashtëm të marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm, siç përcaktohet në nenet 14 deri në 16 të kësaj rregulloreje, çdo institucion duhet të marrë një përmbledhje të vlerësimit dhe të sigurojë që merr parasysh strukturën e tij specifike dhe rreziqet brenda procesit të vendimmarrjes;
- 3.4. kur regjistri i të gjitha marrëveshjeve ekzistuese të kontraktimit të jashtëm, siç përcaktohet në nenin 15 të kësaj rregulloreje, krijohet dhe mbahet në mënyrë qendrore brenda një grupi ose skeme të mbrojtjes institucionale, të gjitha institucionet duhet të jenë në gjendje të marrin regjistrin e tyre individual pa vonesa të panevojshme. Ky regjistër duhet të përfshijë të gjitha marrëveshjet e kontraktimit të jashtëm, duke përfshirë marrëveshjet e kontraktimit të jashtëm me ofruesit e shërbimeve brenda atij grupi ose skemës së mbrojtjes institucionale;
- 3.5. kur ato institucione mbështeten në një plan daljeje për një funksion kritik ose të rëndësishëm që është krijuar në nivel grupi, brenda skemës së mbrojtjes institucionale ose nga organi qendror, të gjitha institucionet duhet të marrin një përmbledhje të planit dhe të jenë të kënaqura që plani mund të ekzekutohet në mënyrë efektive.

KAPITULLI III

MENAXHIMI I KONTRAKTIMIT TË JASHTËM

Neni 5

Vlerësimi i marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm

1. Institucionet duhet të përcaktojnë rastet kur një institucion ia beson një ofruesi shërbimesh kryerjen e proceseve, shërbimeve ose aktiviteteve bie nën përkufizimin e kontraktimit të jashtëm.
2. Për qëllime të kësaj rregulloreje, rastet e mëposhtme nuk konsiderohen si kontraktim i jashtëm:
 - 2.1. shërbimet e komunikimit financiar global (p.sh. SWIFT) nëse burimet kryesore të sistemit të informacionit të nevojshëm për ofrimin e një shërbimi të tillë janë brenda institucionit;
 - 2.2. funksioni që kërkohet ligjërisht të kryhet nga një ofrues shërbimesh (p.sh. auditimi ligjor);
 - 2.3. shërbimet e informacionit të tregut (p.sh. ofrimi i të dhënave nga Bloomberg, Moody's, Standard & Poor's, Fitch);
 - 2.4. infrastrukturat e rrjetit global (p.sh. Visa, MasterCard) dhe shërbimet e telekomunikacionit;
 - 2.5. marrëveshjet për kliring dhe shlyerje ndërmjet shtëpive (zyrave) të kliringut, palëve kontraktuale qendrore dhe institucioneve të shlyerjes dhe anëtarëve të tyre;
 - 2.6. infrastrukturat globale të mesazheve financiare që i nënshtrohen mbikëqyrjes nga autoritetet përkatëse;
 - 2.7. shërbimet bankare korrespondente;
 - 2.8. blerja e shërbimeve që përndryshe nuk do të ndërmerreshin nga institucioni (p.sh. këshilla nga një arkitekt, ofrimi i opinionit ligjor dhe përfaqësimi përpara gjykatës dhe organeve administrative, pastrimi, kopshtaria dhe mirëmbajtja e ambienteve të institucionit, shërbimet mjekësore, servisi i veturave të kompanisë, shërbimet ushqimore, shërbimet e automatëve shitës, shërbimet administrative në zyrë, shërbimet e udhëtimit, shërbimet postare, recepsionistët, sekretarët dhe operatorët në qendrën e thirrjeve), mallrat (p.sh. kartat plastike, lexuesit e kartave, furnizimet e zyrës, kompjuterët personalë, mobilet) ose shërbimet publike/ komunalitë (p.sh. energjia elektrike, gazi, uji, linja telefonike);
 - 2.9. softueri i cili, duke qenë i gatshëm për përdorim, është i disponueshëm komercialisht në treg dhe nuk kërkon personalizim të konsiderueshëm; dhe
 - 2.10. shërbimet tjera të ngjashme me ato sipas nënparagrafëve 2.1 deri në 2.9 të këtij paragrafi duke iu nënshtuar opinionit paraprak të BQK-së që deklaron se dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për përdorimin e këtyre shërbimeve.
3. Institucionet nuk transferojnë autorizimet dhe kompetencat e organeve të tyre drejtuese dhe mbikëqyrëse te ofruesi i shërbimit.
4. Çdo ofrues shërbimesh i përfshirë në kontraktimin e jashtëm duhet të ketë një identitet ligjor të veçantë të dallueshëm nga institucioni që i jashtë kontrakton shërbimet.
5. Institucionet duhet që, në përpjesëtim me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të tyre dhe rreziqet e qenësishme në modelin e tyre të biznesit, menaxhojnë rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuara apo mund të ekspozohen, të cilat rrjedhin nga fakti që ia kanë besuar një ofruesi shërbimesh kryerjen e proceseve, shërbimeve ose aktiviteteve, pavarësisht nëse ai ofrues i besuar shërbimesh bie nën përkufizimin e kontraktimit të jashtëm.

6. Opinioni paraprak i BQK-së i përcaktuar në paragrafin 2.10 të paragrafit 2 të këtij neni, nëse ka të bëjë me një aplikacion apo kërkesë nga një institucion, ofrues shërbimesh apo institucion i ardhshëm apo ofrues shërbimesh i ardhshëm, lëshohet brenda periudhës maksimale prej dy muajsh nga data e dorëzimit të aplikacionit ose kërkesës.

Neni 6

Vlerësimi i domosdoshmërisë ose rëndësisë së funksionit/shërbimit që do të kontraktohet nga jashtë

1. Institucionet duhet të konsiderojnë gjithmonë një funksion si të domosdoshëm ose të rëndësishëm në situatat e mëposhtme:
 - 1.1. kur një defekt ose dështim në performancën e tij do të dëmtonte ndjeshëm performancën financiare dhe vazhdimësinë e veprimtarisë së institucionit.
 - 1.2. kur detyrat operationale të funksioneve të kontrollit të brendshëm jashtë kontraktohen, duhet të kryhet një vlerësim për të përcaktuar nëse një dështim për të ofruar funksionin e jashtë kontraktuar ose ofrimi i papërshtatshëm i tij do të ndikonte negativisht në efektivitetin e funksionit të kontrollit të brendshëm.
2. Është e nevojshme të përcaktohet domosdoshmëria ose rëndësia e funksionit që do të jashtë kontraktohet në mënyrë që të menaxhohet rreziku i kontraktimit të jashtëm.
3. Institucionet duhet të vendosin kritere dhe të përcaktojnë metodologjinë në mënyrë që të vlerësojnë domosdoshmërinë ose rëndësinë e një funksioni, duke përfshirë ndikimin e tij në pajtueshmërinë rregullatore dhe licencimin, ndikimin në performancën financiare, kontributin në qëndrueshmërinë operationale dhe vazhdimësinë e shërbimeve, rëndësinë në ruajtjen e besimit të klientëve dhe cilësisë së shërbimeve, ndikimin e mundshëm në reputacionin e institucionit ose pozicionit në treg, dhe shkallën e varësisë nga operationet kryesore të biznesit.
4. Vlerësimi i domosdoshmërisë ose rëndësisë është një proces i vazhdueshëm që duhet të kryhet në intervale të rregullta. Vlerësimi i domosdoshmërisë ose rëndësisë duhet të rishikohet rregullisht për t'u siguruar që të mbetet relevant teksa kushtet e biznesit, rregulloret dhe operationet ndryshojnë me kalimin e kohës.
5. Vlerësimi i funksioneve të domosdoshme ose të rëndësishme përfshin një qasje të strukturuar për të përcaktuar rëndësinë e secilit funksion për operationet e institucionit dhe detyrimet rregullatore. Ky vlerësim është thelbësor për të marrë vendime të informuara në lidhje me kontraktimin e jashtëm dhe për të siguruar që marrëveshjet e kontraktimit të jashtëm nuk rrezikojnë qëndrueshmërinë operationale ose pajtueshmërinë rregullatore.

Neni 7

Struktura organizative

1. Institucionet sigurojnë:
 - 1.1. një proces vendimmarrjeje të qartë, transparent dhe të dokumentuar për kontraktimin e jashtëm;
 - 1.2. një ndarje të qartë të kompetencave dhe përgjegjësi të njësive organizative ose punonjësve përgjegjës për dokumentimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e procesit të lidhjes dhe zbatimit të çdo marrëveshje të kontraktimit të jashtëm; dhe

- 1.3. burimet e duhura për të siguruar pajtueshmërinë me dispozitat e rregulloreve dhe praktikat e mira që rregullojnë kontraktimin e jashtëm.
2. Institucionet duhet të krijojnë një funksion të kontraktimit të jashtëm ose caktojnë një anëtar të lartë të stafit (p.sh. një person përgjegjës për punën e një funksioni kontrolli) përgjegjës për mbikëqyrjen e rrezeve të marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm dhe mbikëqyrjen e dokumentacionit të marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, institucionet mund t'ia caktojnë funksionin e kontraktimit të jashtëm një anëtar të menaxhmentit të lartë.
4. Gjatë kontraktimit të jashtëm, institucionet sigurojnë të paktën sa vijon:
 - 4.1. miratimin dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me aktivitetet e tyre të punës dhe funksionet e domosdoshme ose të rëndësishme;
 - 4.2. vazhdimin e sjelljes së rregullt të punës së tyre dhe ofrimit të shërbimeve financiare;
 - 4.3. identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe zbutjen e duhur të rrezeve që rrjedhin nga kontraktimi i jashtëm;
 - 4.4. aty ku është e aplikueshme, rregullime të përshtatshme të konfidencialitetit në lidhje me të dhënat dhe informacionet e tjera;
 - 4.5. mbajtjen e një rrjedhe të duhur të informacionit përkatës me ofruesit e shërbimeve;
 - 4.6. në lidhje me kontraktimin e jashtëm të funksioneve të domosdoshme ose të rëndësishme, ndërmarrjen e të paktën një prej veprimeve të mëposhtme, brenda një afati kohor të përshtatshëm:
 - 4.6.1.1. transferimi i funksionit tek ofruesit alternativë të shërbimeve;
 - 4.6.1.2. riintegrimi i funksionit në institucion; ose
 - 4.6.1.3. ndërprerja e aktiviteteve të punës që varen nga funksioni; dhe
 - 4.7. kur të dhënat personale përpunohen nga ofruesit e shërbimeve të vendosur në vendet e treta, të dhënat përpunohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Institucionet sigurojnë që kontraktimi i jashtëm të mos rezultojë në transferimin e përgjegjësisë nga personat përgjegjës të institucionit te ofruesi i shërbimeve.

Neni 8

Kontraktimi i jashtëm nga një grup institucione

1. Kur institucioni kontraktin nga jashtë funksione të ofruesit të shërbimeve brenda grupit të institucioneve të cilave i përket, bordi drejtues dhe ai mbikëqyrës i institucionit që ka jashtë kontraktuar aktivitetin ose shërbimin në fjalë janë, në përputhje me kompetencat e tyre, përgjegjës edhe për ato shërbime dhe aktivitetet të jashtë kontraktuara dhe mbajnë përgjegjësinë e plotë për pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat rregullatore dhe zbatimin efektiv të kësaj rregulloreje.
2. Kur institucioni ia beson kryerjen e disa detyrave të funksionit të kontrollit një ofruesi shërbimesh brenda grupit të institucioneve të cilat i përket, për monitorimin dhe auditimin e marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm, ai sigurohet që këto detyra operationale të kryhen në mënyrë efektive, duke përfshirë marrjen e raporteve të duhura.
3. Kur monitorimi operacional i një marrëveshjeje të caktuar të kontraktimit të jashtëm është i centralizuar brenda grupit të institucioneve të cilave i përket një institucion (p.sh., si pjesë e një marrëveshjeje të përgjithshme për monitorimin e marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm),

institucioni sigurohet që, të paktën për funksione e domosdoshme ose të rëndësishme të jashtë kontraktuara:

- 3.1. është i mundur si monitorimi i pavarur i ofruesit të shërbimeve ashtu edhe mbikëqyrja e duhur, përfshirë edhe duke pranuar, të paktën çdo vit dhe në bazë të kërkesës nga funksioni i centralizuar i monitorimit të grupit të institucioneve, raporte që përfshijnë, të paktën, një përmbledhje të vlerësimit të rrezikut dhe monitorimit të performancës; dhe
- 3.2. është e mundur të merret nga funksioni i centralizuar i monitorimit të grupit të institucioneve një përmbledhje e raporteve përkatëse të auditimit për marrëveshjet e domosdoshme ose të rëndësishme të kontraktimit të jashtëm, në bazë të kërkesës, raporti i plotë i auditimit.
4. Institucioni sigurohet që organi i tij drejtues do të njoftohet siç duhet për ndryshimet përkatëse të planifikuara në lidhje me ofruesit e shërbimeve që monitorohen në mënyrë qendrore brenda grupit të institucioneve të cilave i përket ky institucion dhe për ndikimin e mundshëm të këtyre ndryshimeve në funksionet e domosdoshme ose të rëndësishme të ofruara, duke përfshirë një përmbledhje e analizës së rreziqeve, përfshirë edhe rreziqet ligjore, pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe ndikimin në nivelet e shërbimeve.
5. Kur institucioni mbështetet në një vlerësim të marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm, siç përcaktohet në nenin 14 të kësaj rregulloreje, i cili kryhet në mënyrë qendrore brenda grupit të institucioneve të cilit i përket ky institucion, përpara se të hyjë në një marrëveshje me një ofrues shërbimesh, duhet të sigurohet që të marrë një përmbledhje të vlerësimit dhe sigurohet që struktura dhe rreziqet e tij specifike të merren parasysh gjatë procesit të vendimmarrjes.
6. Kur regjistri i të gjitha marrëveshjeve ekzistuese të kontraktimit të jashtëm mbahet në mënyrë qendrore brenda grupit të institucioneve të cilit i përket një institucion, institucioni sigurohet që të jetë në gjendje të marrë pa vonesë regjistrin e tij individual, i cili përmban të gjitha marrëveshjet e kontraktimit të jashtëm me ofruesit e shërbimeve, duke përfshirë marrëveshjet e kontraktimit të jashtëm me ofruesit e shërbimeve brenda atij grupi të institucioneve, të paktën në masën e përcaktuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje.
7. Kur institucioni mbështetet në një plan daljeje për një funksion të domosdoshëm ose të rëndësishëm që është krijuar për grupin e institucioneve të cilit i përket ky institucion, ai sigurohet që të marrë një përmbledhje të planit dhe të jetë i bindur që plani mund të zbatohet në mënyrë efektive.

Neni 9

Politika e kontraktimit të jashtëm

1. Në politikat e tyre, institucionet përcaktojnë parimet, përgjegjësitë dhe procedurat në lidhje me kontraktimin e jashtëm.
2. Bordi drejtues i institucioneve miraton dhe shqyrton rregullisht politikat nga paragrafi 1 i këtij neni.
3. Politikat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni përmbajnë së paku kriteret dhe procedurat që kanë të bëjnë me:
 - 3.1. procesin e miratimit të vendimeve për kontraktimin e jashtëm;
 - 3.2. planifikimin e marrëveshjeve të kontraktimit:
 - 3.2.1.1. përcaktimin e kërkesave të biznesit në lidhje me kontraktimin e jashtëm;

- 3.2.1.2. përcaktimin e funksioneve kritike ose të rëndësishme;
- 3.2.1.3. përcaktimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve që rrjedhin nga kontraktimi i jashtëm;
- 3.2.1.4. kontrollet e kujdesit të duhur për ofruesit e mundshëm të shërbimeve;
- 3.2.1.5. identifikimin, vlerësimin, menaxhimin, zbutjen ose parandalimin e konflikteve aktuale ose të mundshme të interesit;
- 3.2.1.6. planifikimin e vazhdimësisë së biznesit; dhe
- 3.2.1.7. miratimin e marrëveshjeve të reja të kontraktimit të jashtëm;
- 3.3. zbatimin, monitorimin dhe menaxhimin e marrëveshjeve të kontraktimit nga jashtë, duke përfshirë:
 - 3.3.1.1. vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së ofruesit të shërbimit;
 - 3.3.1.2. procedurat për t'u njoftuar dhe për t'iu përgjigjur ndryshimeve në një marrëveshje të kontraktimit nga jashtë ose ofrues shërbimi;
 - 3.3.1.3. rishikimin dhe auditimin e pavarur të pajtueshmërisë me kërkesat dhe politikat ligjore dhe rregullatore; dhe
 - 3.3.1.4. proceset e rinovimit;
- 3.4. mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe regjistrin; dhe
- 3.5. strategjitë e daljes dhe proceset e ndërprerjes ose anulimit, duke përfshirë një kërkesë për një plan të dokumentuar daljeje për çdo funksion kritik ose të rëndësishëm që do të kontraktohet nga jashtë, kur një dalje e tillë konsiderohet e mundshme duke marrë parasysh ndërprerjet e mundshme të shërbimit ose anulimin ose përfundimin e papritur të një marrëveshjeje të kontraktimit nga jashtë me ofruesin e shërbimit.

Neni 10

Konflikti i interesit

1. Institucionet, në përputhje me nenin 11 të Rregullores për qeverisjen korporative të bankave, institucioneve të parasë elektronike, institucioneve të pagesave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare duhet të identifikojnë, vlerësojnë dhe menaxhojnë konfliktet e interesave në lidhje me marrëveshjet e tyre të kontraktimit nga jashtë.
2. Aty ku kontraktimi i jashtëm krijon konflikte materiale të interesit, duke përfshirë midis subjekteve brenda të njëjtit grup ose skemë të mbrojtjes institucionale, institucionet dhe institucionet e pagesave duhet të marrin masat e duhura për të menaxhuar ato konflikte të interesit.
3. Kur funksionet ofrohen nga një ofrues shërbimi që është pjesë e një grupi ose anëtar i një skeme mbrojtjeje institucionale ose që është në pronësi të institucionit, institucionit të pagesave, grupit ose institucioneve që janë anëtare të një skeme të mbrojtjes institucionale, kushtet, duke përfshirë ato financiare, për shërbimin e kontraktuar nga jashtë duhet të përcaktohen në mënyrë të barabartë. Megjithatë, brenda çmimit të shërbimeve mund të përfshihen sinergjitë që rezultojnë nga ofrimi i shërbimeve të njëjta ose të ngjashme për disa institucione brenda një grupi ose një skeme të mbrojtjes institucionale, për aq kohë sa ofruesi i shërbimit mbetet i aftë të funksionojë në mënyrë të pavarur dhe të vazhdueshme; brenda një grupi kjo duhet të jetë pavarësisht nga dështimi i ndonjë entiteti tjetër të grupit.

Neni 11

Planet e vazhdimësisë së biznesit

1. Institucionet, në përputhje me kërkesat e nenit 17 të Rregullores për teknologjinë e informacionit për bankat, institucionet e parasë elektronike dhe institucionet e pagesave duhet të kenë, të mbajnë dhe testojnë periodikisht planet e duhura të vazhdimësisë së biznesit në lidhje me funksionet kritike ose të rëndësishme të kontraktuara nga jashtë. Institucionet dhe institucionet e pagesave brenda një grupi ose skeme të mbrojtjes institucionale mund të mbështeten në planet e vazhdimësisë së biznesit të vendosura nga qendra në lidhje me funksionet e tyre të kontraktimit nga jashtë.
2. Planet e vazhdimësisë së biznesit duhet të marrin parasysh ngjarjen e mundshme që cilësia e ofrimit të funksionit kritik ose të rëndësishëm të kontraktimit nga jashtë përkeqësohet në një nivel të papranueshëm ose dështon. Plane të tilla duhet gjithashtu të marrin parasysh ndikimin e mundshëm të falimentimit ose dështimet e tjera të ofruesve të shërbimeve dhe, aty ku është e përshtatshme, rreziqet politike në juridiksionin e ofruesit të shërbimit.

Neni 12

Funksioni i auditimit të brendshëm

1. Aktivitetet e funksionit të auditimit të brendshëm duhet të mbulojnë, duke ndjekur një qasje të bazuar në rrezik, rishikimin e pavarur të aktiviteteve të kontraktuara nga jashtë. Plani dhe programi i auditimit duhet të përfshijë, në veçanti, marrëveshjet e kontraktimit të jashtëm të funksioneve kritike ose të rëndësishme.
2. Në lidhje me procesin e kontraktimit të jashtëm, funksioni i auditimit të brendshëm duhet të paktën të konstatojë:
 - 2.1. që korniza e institucionit për kontraktimin e jashtëm, duke përfshirë politikën e kontraktimit të jashtëm, është zbatuar në mënyrë korrekte dhe efektive dhe është në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, strategjinë e rrezikut dhe vendimet e organit menaxhues;
 - 2.2. përshtatshmërinë, cilësinë dhe efektivitetin e vlerësimit të rëndësisë kritike ose rëndësisë së funksioneve;
 - 2.3. përshtatshmërinë, cilësinë dhe efektivitetin e vlerësimit të rrezikut për marrëveshjet e kontraktimit të jashtëm dhe që rreziqet të mbeten në përputhje me strategjinë e rrezikut të institucionit;
 - 2.4. përfshirjen e duhur të organeve qeverisëse; dhe
 - 2.5. monitorimin dhe menaxhimin e duhur të marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm.

Neni 13

Të dhënat e aktiviteteve të kontraktimit nga jashtë

1. Institucionet duhet të mbajnë të dhëna të përditësuara të aktiviteteve të kontraktimit nga jashtë të lidhura me sistemin e informacionit, që përmbajnë:
 - 1.1. numrin e kontratave të kontraktimit të jashtëm;
 - 1.2. datat e lidhjes, ndryshimet e mundshme dhe përfundimin e vlefshmërisë së kontratës;
 - 1.3. të dhënat për ofruesin e shërbimit – emrin e biznesit, selinë, numrin e regjistrimit dhe të dhëna të tjera relevante;

- 1.4. informacionin nëse ofruesi i shërbimit është i lidhur me institucionin nga marrëdhëniet e pronësisë dhe/ose menaxhimit;
 - 1.5. klasifikimin e aktivitetit të kontraktuar nga jashtë që duhet të lehtësojë identifikimin e tij (p.sh. mirëmbajtja e pajisjeve harduerike, zbatimi i komponentëve të softuerit, testimi i penetrimit, mirëmbajtja e aplikacionit bazë të biznesit, etj.);
 - 1.6. një përshkrim të shkurtër të aktivitetit të kontraktuar nga jashtë;
 - 1.7. përshkrimin e të dhënave në të cilat ofruesi i shërbimit ka qasje ose i posedon, dhe/ose informacionin nëse të dhënat janë transferuar te një ofrues tjetër shërbimi;
 - 1.8. informacionin nëse aktiviteti i kontraktuar nga jashtë është kritik/kyç apo ndikon në proceset kritike/kyçe të biznesit;
 - 1.9. emrin e vendit ose vendeve në të cilat kryhet aktiviteti i kontraktuar nga jashtë dhe vendi ose vendet në të cilat ndodhen të dhënat;
 - 1.10. informacionin rreth modelit dhe llojit të shërbimit cloud;
 - 1.11. datën e vlerësimit të fundit të nivelit të shërbimit të ofruar dhe vlerësimin e rrezikut të sistemit të informacionit në lidhje me aktivitetet e kontraktuara nga jashtë;
 - 1.12. informacionin në lidhje me shërbimet e nënkontraktuara nga jashtë (përshkrim i shkurtër i shërbimit, të dhëna bazë për ofruesin e nën-shërbimeve, etj.).
2. Institucionet, kur kërkohet ose në periudhën e përcaktuar nga BQK, i dorëzojnë BQK-së një ekstrakt nga të dhënat që përmban një pasqyrë e të gjitha aktiviteteve të kontraktuara nga jashtë të aktiviteteve të institucionit tek një palë e tretë.

KAPITULLI IV

PROCESI I KONTRAKTIMIT TË JASHTËM

Neni 14

Analiza para kontraktimit të jashtëm

1. Përpara se të miratojnë një vendim për çdo marrëveshje të kontraktimit të jashtëm, institucionet duhet:
 - 1.1. të vlerësojnë nëse marrëveshja e kontraktimit të jashtëm ka të bëjë me një funksion kritik ose të rëndësishëm, siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.2. të vlerësojnë nëse janë plotësuar kushtet e mbikëqyrjes për kontraktimin e jashtëm të përcaktuara në nenin 15 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.3. të identifikojnë dhe vlerësojnë të gjitha rreziqet përkatëse që rrjedhin nga marrëveshja e kontraktimit të jashtëm në përputhje me nenin 16 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.4. të ndërmarrin kujdesin e duhur për ofruesin e ardhshëm të shërbimit në përputhje me nenin 17 të kësaj Rregulloreje; dhe
 - 1.5. të identifikojnë dhe vlerësojnë konfliktet e interesit që mund të shkaktojnë kontraktimi i jashtëm në përputhje me rregulloren përkatëse për qeverisjen e korporatës.

Neni 15

Kushtet e mbikëqyrjes për kontraktimin e jashtëm

1. Kur një institucion kontraktin nga jashtë një funksion të lidhur drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve kryesore financiare tek një ofrues i shërbimeve që ndodhet në Republikën e Kosovës, duhet të plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:
 - 1.1. ofruesi i shërbimit është i autorizuar nga një autoritet kompetent ose i regjistruar në një regjistër të duhur pranë një autoriteti kompetent për të kryer atë funksion; ose
 - 1.2. ofruesi i shërbimit është i autorizuar për të kryer atë funksion nëse një autorizim i tillë specifik për kryerjen e atij funksioni kërkohet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Kur një institucion kontraktin nga jashtë një funksion të lidhur drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve kryesore financiare tek një ofrues shërbimi i vendosur në një vend të tretë, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - 2.1. ofruesi i shërbimit është i autorizuar ose i regjistruar në një regjistër përkatës me një autoritet kompetent për të kryer atë funksion në vendin e tretë dhe mbikëqyret nga një autoritet kompetent përkatës; dhe
 - 2.2. ekziston një marrëveshje e duhur bashkëpunimi ndërmjet BQK dhe autoritetit mbikëqyrës përgjegjës për mbikëqyrjen e ofruesit të shërbimeve të vendit të tretë.
3. Pavarësisht nga funksionet e kontraktimit nga jashtë, një institucion duhet të mbajë në çdo kohë përmbajtje të mjaftueshme dhe të sigurojë që:
 - 3.1. i plotëson të gjitha kushtet e autorizimit të tij në çdo kohë;
 - 3.2. bordet e tij drejtuese dhe mbikëqyrëse kryejnë me efektivitet përgjegjësitë e tyre;
 - 3.3. ruan një kornizë dhe strukturë organizative të qartë dhe transparente që i mundëson të sigurojë pajtueshmërinë me kërkesat e përcaktuara;
 - 3.4. kur detyrat operacionale të funksioneve të kontrollit janë të kontraktuara nga jashtë, monitoron dhe menaxhon rreziqet që rrjedhin nga kontraktimi i funksioneve kritike ose të rëndësishme; dhe
 - 3.5. ka burime të mjaftueshme për të siguruar pajtueshmërinë me nënparagrafët 3.1. deri në 3.4. të këtij paragrafi.

Neni 16

Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve që rrjedhin nga kontraktimi i jashtëm

1. Përpara se të hyjnë në një marrëveshje me një ofrues shërbimi dhe gjatë monitorimit të vazhdueshëm të performancës së ofruesit të shërbimit, institucionet duhet të vlerësojnë rreziqet dhe të krijojnë një sistem të përshtatshëm për menaxhimin e rreziqeve operacionale dhe të përqendrimit dhe rreziqeve të tjera që rrjedhin nga kontraktimi i jashtëm.
2. Kur marrëveshja me një ofrues shërbimi përfshin mundësinë që ofruesi i shërbimit të nënkontrakttoj funksione kritike ose të rëndësishme tek ofruesit e tjerë të shërbimeve, institucionet gjatë kryerjes së vlerësimit të rrezikut marrin parasysh të paktën sa vijon:
 - 2.1. rreziqet që lidhen me nënkontraktimin e jashtëm, duke përfshirë rreziqet shtesë që mund të lindin nëse nënkontraktori ndodhet në një vend të tretë ose në një vend të ndryshëm nga ofruesi i shërbimit; dhe

- 2.2. rreziku që zinxhirët e gjatë dhe kompleks të nënkontraktimit të jashtëm të zvogëlojnë aftësinë e institucionit për të mbikëqyrur funksionin kritik ose të rëndësishëm të jashtëm dhe aftësinë e BQK-së për t'i mbikëqyrur ato në mënyrë efektive.
3. Përpara se të hyjnë në marrëveshje të kontraktimit të jashtëm, institucionet duhet të vlerësojnë ndikimin e mundshëm të marrëveshjeve të kontraktimit të jashtëm në rrezikun operacional dhe të marrin parasysh rezultatet e vlerësimit kur vendosin nëse funksioni duhet t'i jepet një ofruesi shërbimi.
4. Institucionet duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të shmangur rreziqet e panevojshme operacionale para se të hyjnë në marrëveshje të kontraktimit të jashtëm.
5. Rregullat e institucioneve për krijimin dhe zbatimin e një sistemi të menaxhimit të rrezikut sipas akteve ligjore dhe rregulloreve përkatëse të miratuara sipas këtyre ligjeve do të zbatohen *mutatis mutandis* për menaxhimin e rreziqeve që rrjedhin nga kontraktimi i jashtëm.
6. Funksionet e jashtme duhet të mbulohen në mënyrë adekuate nga sistemi i kontrollit të brendshëm të institucioneve. Rregullat e institucioneve për krijimin dhe zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe funksionet e kontrollit sipas ligjeve dhe rregulloreve përkatëse të miratuara sipas këtyre ligjeve do të zbatohen *mutatis mutandis* për funksionet e jashtme.

Neni 17

Kujdesi i duhur

1. Përpara se të hyjnë në marrëveshjet e kontraktimit të jashtëm dhe të marrin parasysh vlerësimin e rreziqeve operacionale në lidhje me funksionin që do të jepet jashtë, institucionet duhet të sigurojnë në procesin e përzgjedhjes dhe vlerësimit që ofruesi i shërbimit është i përshtatshëm.
2. Kur vlerësojnë përshtatshmërinë e një ofruesi të shërbimeve të jashtme për një funksion kritik ose të rëndësishëm, institucionet vlerësojnë nëse ofruesi i shërbimit:
 - 2.1. është me reputacion të mirë;
 - 2.2. ka aftësitë e duhura, ekspertizën, burimet (p.sh., njerëzore, TIK, financiare), strukturën organizative; dhe
 - 2.3. nëse është e aplikueshme, ka autorizimin për të kryer atë funksion ose është regjistruar në një regjister përkatës pranë një autoriteti kompetent.
3. Gjatë kryerjes së kujdesit të duhur për një ofrues të mundshëm të shërbimeve të jashtme të një funksioni kritik ose të rëndësishëm, institucionet duhet të marrin parasysh edhe sa vijon:
 - 3.1. modelin e biznesit të ofruesit të shërbimit, natyrën e tij, shkallën, kompleksitetin, situatën financiare, strukturën e pronësisë dhe, kur ofruesi i shërbimit është anëtar i një grupi, struktura e grupit të cilit i përket;
 - 3.2. marrëdhëniet afatgjata me ofruesit e shërbimeve që tashmë janë vlerësuar dhe kryejnë shërbime për institucionin;
 - 3.3. nëse ofruesi i shërbimit është një ndërmarrje mëmë ose filial i institucionit dhe nëse është pjesë e fushës së konsolidimit kontabël; dhe
 - 3.4. nëse ofruesi i shërbimit mbikëqyret apo jo nga autoriteti mbikëqyrës kompetent.
4. Kur kontraktimi i jashtëm përfshin përpunimin e të dhënave personale ose konfidenciale, institucionet duhet të verifikojnë që ofruesi i shërbimit zbaton masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 18

Marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet institucioneve dhe ofruesit të shërbimeve

1. Kur hyjnë në një marrëveshje me një ofrues shërbimi, institucionet duhet të sigurojnë që qëllimi dhe përmbajtja e dispozitave kontraktuale janë të përshtatshme për rreziqet që lidhen me kontraktimin e jashtëm dhe për qëllimin dhe kompleksitetin e funksioneve të kontraktuara.
2. Institucionet do të lidhin një marrëveshje me shkrim me një ofrues shërbimi e cila duhet të përmbajë të paktën sa vijon:
 - 2.1. një përshkrim të detajuar të funksionit të jashtëm i cili është objekt i marrëveshjes;
 - 2.2. datën e fillimit dhe datën e përfundimit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale;
 - 2.3. detyrimet financiare të palëve;
 - 2.4. dispozitat që rregullojnë mënyrën se si një institucion monitoron në mënyrë të vazhdueshme kryerjen e funksionit që është objekt i marrëveshjes, duke përfshirë llojet e raporteve që do të marrë institucioni nga ofruesi i shërbimit dhe shpeshtësia e dhënies së tyre;
 - 2.5. detyrimin e ofruesit të shërbimit për të njoftuar institucionin në kohën e duhur për të gjitha faktet dhe ndryshimet në rrethanat që kanë ose mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale;
 - 2.6. nivelin e dakorduar të shërbimit dhe cilësinë e funksioneve të kryera, duke përfshirë objektivat cilësore dhe, sipas rastit, sasiore të performancës për funksionin e jashtëm, që mundësojnë veprime korrigjuese në kohë nga institucioni;
 - 2.7. kur është e përshtatshme, detyrimin për sekretin e biznesit dhe detyrimin dhe mënyrën e mbrojtjes së të dhënave konfidenciale dhe personale, duke përfshirë dispozitat në lidhje me qasjen, disponueshmërinë, integritetin, privatësinë dhe sigurinë e të dhënave përkatëse;
 - 2.8. aty ku është e përshtatshme, vendndodhjen(et) ku do të ofrohet funksioni i jashtëm dhe ku të dhënat përkatëse do të mbahen, përpunohen dhe ruhen, duke përfshirë kërkesën për të njoftuar institucionin nëse ofruesi i shërbimit propozon të ndryshojë vendndodhjen(et);
 - 2.9. dispozitat nëse lejohet nënkontraktimi i jashtëm i funksionit;
 - 2.10. obligimin e ofruesit të shërbimeve për të ofruar shërbimet në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi të Republikës së Kosovës;
 - 2.11. obligimin e ofruesit të shërbimeve për të siguruar qasjen dhe të drejtat e inspektimit në terren nga BQK në mënyrë të përcaktuar në nenin 22, paragrafi 1. të kësaj Rregulloreje;
 - 2.12. dispozitat që sigurojnë që të dhënat që janë në pronësi të institucionit mund të jenë të qasshme në rast të shpërbërjes ose ndërprerjes së operacioneve të biznesit të ofruesit të shërbimit (p.sh. falimentimi, zgjidhja, mbyllja ose procedura të ngjashme);
 - 2.13. dispozitat nëse ofruesi i shërbimit duhet të marrë një policë sigurimi profesional për dëmshpërblim dhe, nëse është e aplikueshme, nivelin e mbulimit të kërkuar të sigurimit;
 - 2.14. obligimin e ofruesit të shërbimeve për të bashkëpunuar me BQK-në si autoritete kompetente dhe autoritete për përmbylljen e institucionit;
 - 2.15. kohëzgjatjen e marrëdhënies kontraktuale ose një tregues se marrëveshja është me kohëzgjatje të pacaktuar;
 - 2.16. një përshkrim të kushteve për përfundimin dhe/ose anulimin e marrëveshjes me periudha të përcaktuara njoftimi për institucionin dhe për ofruesin e shërbimit;

- 2.17. të drejtat e institucionit për të ndërprerë ose anuluar një marrëveshje me ofruesin e shërbimit, nëse kjo urdhërohet nga BQK;
 - 2.18. përcaktimin e Ligjit në fuqi; dhe
 - 2.19. mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.
3. Kur institucionet dhe ofruesi i shërbimit lidhin një marrëveshje kontraktimi të jashtëm për funksione kritike ose të rëndësishme, marrëveshja, përveç përmbajtjes së specifikuar në paragrafin 2, duhet të përmbajë sa vijon:
 - 3.1. detyrimin e ofruesit të shërbimit për të siguruar qasjen dhe të drejtat e auditimit për institucionin në mënyrën e përcaktuar në nenin 22, paragrafi 2 i kësaj rregulloreje;
 - 3.2. dispozitat për zbatimin dhe testimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit;
 - 3.3. detyrimet e ofruesit të shërbimit në rastin e transferimit të funksionit të jashtëm te një ofrues tjetër shërbimi ose përsëri te institucioni, përfshirë detyrimet në lidhje me trajtimin e të dhënave;
 - 3.4. vendosjen e një periudhe të përshtatshme kaluese, gjatë së cilës ofruesi i shërbimit, pas përfundimit ose anulimit të marrëveshjes së kontraktimit të jashtëm, do të vazhdojë të ofrojë funksionin e kontraktuar nga jashtë për të zvogëluar rrezikun e ndërprerjeve; dhe
 - 3.5. detyrimin e ofruesit të shërbimit për të mbështetur institucionin në transferimin ose riintegrimin e rregullt të funksionit në rast të anulimit ose përfundimit të marrëveshjes së kontraktimit të jashtëm.
 4. Marrëveshja e kontraktimit të jashtëm duhet të specifikojë nëse lejohet ose jo nën-kontraktimi i jashtëm i funksioneve kritike ose të rëndësishme, ose pjesëve materiale të tyre.
 5. Nëse lejohet nën-kontraktimi i jashtëm i funksioneve kritike ose të rëndësishme, institucionet duhet të përcaktojnë nëse pjesa e funksionit që do të nënkontraktohet nga jashtë është, si e tillë, kritike ose e rëndësishme (p.sh. një pjesë materiale e funksionit kritik ose të rëndësishëm) dhe, nëse është po, ta regjistronë në regjistrë.
 6. Kur një marrëveshje e kontraktimit të jashtëm për funksione kritike ose të rëndësishme përfshin mundësinë e nën-kontraktimit të jashtëm, përveç përmbajtjes së specifikuar në paragrafët 2, dhe 3 të këtij neni, ajo marrëveshje duhet të përmbajë të paktën sa vijon:
 - 6.1. detyrimin e ofruesit të shërbimit për të njoftuar institucionin për çdo nën-kontraktim të jashtëm të planifikuar, ose ndryshime materiale të tij, brenda periudhës që do t'i lejonte institucionit të kryente një vlerësim të rrezikut të ndryshimeve të propozuara dhe, kur është e nevojshme, të kundërshtonte me kohë mënyrën e nën-kontraktimit të jashtëm të planifikuar, ose ndryshimet materiale të tyre;
 - 6.2. të drejtën për të anuluar/ndërprerë marrëveshjen kur nën-kontraktimi i jashtëm rrit rreziqet për institucionin ose kur ofruesi i shërbimit nënkontraktin nga jashtë pa njoftuar institucionin dhe në raste të tjera të justifikuara;
 - 6.3. kur nën-kontraktimi i jashtëm përfshin përpunimin e të dhënave personale, detyrimi i ofruesit të shërbimit për të marrë autorizimin me shkrim të institucionit;
 - 6.4. detyrimin e ofruesit të shërbimit për të mbikëqyrur ato shërbime që ai ka nënkontraktuar nga jashtë;
 - 6.5. kushtet që duhen respektuar në rastin e nën-kontraktimit të jashtëm;
 - 6.6. llojet e funksioneve që nuk mund të nënkontraktohen nga jashtë;

- 6.7. detyrimin e ofruesit të shërbimit për të kërkuar miratimin me shkrim të institucionit për çdo nën-kontraktim të jashtëm të planifikuar, ose ndryshime materiale të tij ose të drejtën për të kundërshtuar kontraktimin e jashtëm të planifikuar; dhe
 - 6.8. detyrimin e ofruesit të shërbimit për të negociuar me nënkontraktorin për të drejtat e qasjes dhe auditimit ose inspektimit në terren në mënyrën e përcaktuar në nenin 22, paragrafi 1 i kësaj rregulloreje.
7. Institucionet mund të lejojnë nën-kontraktimin e jashtëm vetëm kur nënkontraktori merr përsipër të veprojë në përputhje me Ligjin në fuqi dhe kërkesat rregullatore, të respektojë detyrimet përkatëse kontraktuale dhe t'i sigurojë institucionit dhe BQK të njëjtat të drejta qasjeje dhe auditimi ose inspektimi në vend si ato të dhëna nga ofruesi i shërbimit në përputhje me nenin 22 të kësaj rregulloreje.
 8. Institucionet duhet të sigurojnë që ofruesi i shërbimit të mbikëqyrë siç duhet ofruesit e nën-shërbimeve, në përputhje me politikën e përcaktuar nga institucioni. Nëse nën-kontraktimi i jashtëm i propozuar mund të ketë efekte negative materiale në marrëveshjen e kontraktimit të jashtëm të një funksioni kritik ose të rëndësishëm ose do të çonte në një rritje materiale të rrezikut, përfshirë këtu kur kushtet në paragrafin 7 të këtij neni nuk do të plotësoheshin, institucioni duhet të ushtrojë të drejtën e tyre për të kundërshtuar nën-kontraktimin e jashtëm, nëse është rënë dakord për një të drejtë të tillë, dhe/ose për të përfunduar kontratën.

Neni 19

Siguria e të dhënave dhe sistemeve

1. Institucionet sigurojnë që ofruesit e shërbimeve, aty ku është e përshtatshme, të jenë në përputhje me standardet e duhura të sigurisë të TIK-ut.
2. Në rastin e kontraktimit të jashtëm tek ofruesit e shërbimeve cloud ose kontraktimeve tjera të jashtme të TIK-ut, institucionet duhet të përcaktojnë kërkesat e sigurisë së të dhënave dhe sistemeve në kuadër të marrëveshjes për kontraktim të jashtëm dhe monitorojnë pajtueshmërinë me këto kërkesa në baza të vazhdueshme.
3. Përpara se të hyjnë në një marrëveshje me ofruesit e shërbimeve cloud ose marrëveshje të tjera që përfshijnë trajtimin ose transferimin e të dhënave personale ose konfidenciale, institucionet i vlerësojnë rreziqet që lidhen me ruajtjen e të dhënave dhe lokacionet e përpunimit të të dhënave (p.sh, shteti ose rajoni) dhe të sigurojnë që këto rreziqe janë brenda kufijve të pranueshëm.
4. Gjatë kontraktimit të jashtëm, veçanërisht tek vendet e treta, institucionet i marrin parasysh dallimet në dispozitat kombëtare në lidhje me mbrojtjen e të dhënave.

Neni 20

Kontraktimi i jashtëm i Cloud

1. Kontraktimi i jashtëm i *cloud* kryhet në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
2. Në rast të kontraktimit të jashtëm të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, institucioni përcakton gjithashtu:
 - 2.1. role dhe përgjegjësi të qarta për sigurinë e informacionit të ofruesit të shërbimeve cloud ndaj institucionit;
 - 2.2. përgjegjësitë për mirëmbajtjen e komponentëve të harduerit dhe softuerit sipas kërkesave të prodhuesit, testimin dhe aplikimin e patch-eve të sigurisë;

- 2.3. mënyrën e menaxhimit të incidenteve në mënyrë që të përcaktohen procedurat dhe rolet për zgjidhjen e incidenteve, si dhe mënyra e raportimit për incidentin dhe pasojat e tij për institucionin;
- 2.4. mekanizmin e sigurt të autentikimit dhe/ose kontrollin e qasjes në të dhëna dhe shërbime duke përdorur autentikimin me shumë faktorë;
- 2.5. procedurat që sigurojnë enkriptim adekuat të të dhënave gjatë transmetimit, deponimit dhe ruajtjes së kopjeve rezervë të të dhënave.
3. Institucioni që synon të kryejë kontraktim të jashtëm të cloud merr gjithashtu parasysh pikat vijuese kur vlerëson rrezikun e një kontraktimi të tillë të jashtëm:
 - 3.1. modelin e zbatimit të shërbimeve cloud (publik, privat, të përbashkët, hibrid, etj.);
 - 3.2. llojin e shërbimeve cloud (infrastruktura si shërbim – IaaS, platforma si shërbim – PaaS dhe softueri si shërbim – SaaS, etj.);
 - 3.3. ndikimin e migrimit të të dhënave dhe zbatimin e burimeve në llojin e zgjedhur të shërbimeve cloud;
 - 3.4. kapacitetet e rrjetit për transferim të thjeshtë dhe të sigurt të të dhënave (portabiliteti i të dhënave);
 - 3.5. mbrojtjen e të dhënave gjatë migrimit dhe ruajtjes së cloud.
4. Kur bëhet kontraktimi i jashtëm i cloud, institucioni zhvillon një strategji adekuate daljeje në rast të ndërprerjes së ofrimit të këtyre shërbimeve, e cila përfshin gjithashtu procedura që rregullojnë ndërprerjen dhe rivendosjen e shërbimeve cloud ose transferimin e tyre tek një ofrues tjetër shërbimi ose ai institucion, si dhe plane të detajuara për migrimin e të dhënave dhe/ose burimeve të sistemeve të informacionit në varësi të llojit të shërbimeve cloud.
5. Institucioni siguron që çdo kontratë për kontraktim të jashtëm të cloud përmban gjithashtu dispozita që rregullojnë pronësinë e të dhënave, mënyrën e qasjes së të dhënave dhe shërbimeve, si dhe shkarkimin e të dhënave të institucionit në një format të lexueshëm pas ndërprerjes së ofrimit të atij shërbimi dhe fshirjen e tyre adekuate nga ofruesi i shërbimit.

Neni 21

Menaxhimi i rrezikut i të dhënave të ndjeshme

1. Me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së të dhënave dhe menaxhimit efektiv të rreziqeve që lidhen me humbjen, ndryshimin, shkatërrimin ose shpalosjen e paautorizuar e të dhënave të ndjeshme, BQK pret që institucionet të:
 - 1.1. identifikojnë dhe klasifikojnë të gjitha funksionet përkatëse dhe të dhënat konfidenciale dhe sistemet e ndërlidhura, si dhe masat e përcaktuara për mbrojtjen e këtyre të dhënave;
 - 1.2. zbatojnë masat e duhura për t'i siguruar dhe mbrojtur të dhënat e tyre dhe për t'i përcaktuar këto masa në politikën e kontraktimit të jashtëm dhe marrëveshjet e kontratave që rregullojnë marrëveshjet për kontraktim të jashtëm, veçanërisht për shërbimet kritike dhe të rëndësishme;
 - 1.3. kenë një strategji të dokumentuar të menaxhimit të të dhënave që adreson gamën e rreziqeve, të cilat mund të lindin në kontekstin e kontraktimit të jashtëm dhe marrin parasysh rreziqet e mundshme, në veçanti rrezikun operacional, duke përfshirë rrezikun ligjor, rrezikun e lidhur me TIK, pajtueshmërinë dhe rreziqet e reputacionit, dhe kufijtë e mundshëm të kontrollit për kryerjen e aktiviteteve të jashtë kontraktuara.

- 1.4. gjatë kryerjes së vlerësimeve të rrezikut, të marrin parasysh karakteristikat e të dhënave të konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe autentikimit të të dhënave dhe informatave të kërkuara për të ofruar funksione të jashtë kontraktuara biznesi ose shërbimi.
2. Institucionet sipas kësaj Rregulloreje duhet të sigurojnë që çdo transmetim i të dhënave personale të kryhet në përputhje me Ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 22

Të drejtat e qasjes dhe auditimit ose inspektimit në vendndodhje

1. Në kuadër të marrëveshjes për kontraktim të jashtëm me ofruesin e shërbimeve, institucionet garantojnë që ofruesi i shërbimit t'i sigurojë BQK-së ose cilitdo personi të caktuar nga BQK për këtë qëllim si në vijim:
 - 1.1. qasje në kohë dhe të plotë në mjediset e biznesit, duke përfshirë pajisjet, sistemet, rrjetet, informacionin dhe të dhënat e përdorura për ofrimin e funksionit të jashtë kontraktuar, duke përfshirë informacionin financiar përkatës, personelin dhe auditorët e jashtëm të ofruesit të shërbimit; dhe
 - 1.2. kryerjen e inspektimeve në vendndodhje të një pjese të operimit të ofruesit të shërbimit që lidhet ose mund të lidhet me kontraktimin e jashtëm, si dhe inspektimet në vendndodhje të kryerjes së funksioneve që janë objekt i marrëveshjes me ofruesin e shërbimit; për t'i mundësuar atyre ta monitorojnë marrëveshjen për kontraktim të jashtëm dhe të sigurojnë pajtueshmëri me të gjitha kërkesat rregullatore dhe kontraktuale të zbatueshme.
2. Për sa i përket kontraktimit të jashtëm të funksioneve kritike ose të rëndësishme, institucionet garantojnë, në kuadër të marrëveshjes për kontraktim të jashtëm me ofruesin e shërbimit, që ofruesi i shërbimit t'i sigurojë institucionit, auditorëve të tij të jashtëm dhe personave të tjerë që i emëron për këtë qëllim dhe BQK-së si autoritete zgjidhjeje të përcaktuara sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit në fuqi për administrimin zyrtarë dhe likuidimin që rregullojnë përmbylljen (ang. “*resolution*”) e institucioneve, si në vijim:
 - 2.1. qasjen në kohë dhe të plotë në mjediset e biznesit, duke përfshirë pajisjet, sistemet, rrjetet, informacionin dhe të dhënat e përdorura për ofrimin e funksionit të kontraktimit të jashtëm, duke përfshirë informacionin financiar përkatës, personelin dhe auditorët e jashtëm të ofruesit të shërbimit; dhe
 - 2.2. kryerjen e auditimeve ose rishikimeve të një pjese të operimit të ofruesit të shërbimit që lidhet ose mund të lidhet me kontraktimin e jashtëm, si dhe rishikimet e performancës së funksioneve të kontraktimit të jashtëm, të cilat janë objekt i marrëveshjes me ofruesin e shërbimit, për t'i mundësuar atyre që ta monitorojnë marrëveshjen për kontraktim të jashtëm dhe për të siguruar pajtueshmëri me të gjitha kërkesat rregullatore dhe kontraktuale të zbatueshme.
3. Institucionet sigurojnë, në kuadër të marrëveshjes për kontraktim të jashtëm me ofruesin e shërbimit, që funksioni i tij i auditimit të brendshëm të jetë në gjendje ta rishikojë funksionin e jashtë kontraktuar duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik.
4. Institucionet ushtrojnë të drejtat e tyre të qasjes dhe auditimit të përcaktuara në këtë nen dhe përcaktojnë shpeshtësinë e auditimit dhe fushat që do të auditohen sipas një qasjeje të bazuar në rrezik.

5. Për qëllime të kryerjes së auditimeve dhe rishikimeve të përcaktuara në paragrafin 2, nënparagrafi 2.2 të këtij neni, institucioni mund të përdor:
 - 5.1. auditime të grumbulluara të organizuara së bashku me klientë të tjerë të të njëjtit ofrues shërbimi dhe të kryera nga institucioni dhe këta klientë ose nga një palë e tretë e caktuar prej tyre; dhe
 - 5.2. certifikimet e palëve të treta dhe raportet e auditimit të brendshëm ose të palëve të treta, të vëna në dispozicion nga ofruesi i shërbimit.
6. Për kontraktimin e jashtëm të funksioneve kritike ose të rëndësishme, institucioni vlerëson nëse certifikimet dhe raportet e palëve të treta, siç përcaktohet në paragrafin 5, nënparagrafi 5.2 i këtij neni, janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për kryerjen e auditimeve dhe rishikimeve të duhura të marrëveshjeve për kontraktim të jashtëm dhe të mos mbështeten vetëm në këto raporte me kalimin e kohës.
7. Kur marrëveshja për kontraktim të jashtëm mbart një nivel të lartë kompleksiteti teknik, për shembull në rastin e kontraktimit të jashtëm të cloud, institucioni duhet të verifikojë:
 - 7.1. nëse personat e përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni që kryejnë auditimin dhe/ose vlerësimin kanë aftësi dhe njohuri të përshtatshme dhe relevante për t'i kryer auditimet dhe/ose vlerësimet përkatëse në mënyrë efektive; dhe
 - 7.2. nëse personeli i institucionit që shqyrton certifikimet dhe/ose raportet nga personat e përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni ka aftësi dhe njohuri të përshtatshme dhe përkatëse për t'i kryer auditimet dhe/ose rishikimet përkatëse në mënyrë efektive.

Neni 23

Të drejtat e ndërprerjes

1. Marrëveshja për kontraktim të jashtëm duhet t'i lejojë shprehimisht institucionit mundësinë që ta ndërpresë marrëveshjen, në përputhje me Ligjin për Shërbime të Pagesave dhe Ligjin për Banka, duke përfshirë edhe situatat e mëposhtme:
 - 1.1. kur ofruesi i funksioneve të jashtë kontraktuara është në shkelje të Ligjit për Shërbime të Pagesave dhe apo Ligjit për Banka, rregulloreve ose dispozitave kontraktuale në fuqi;
 - 1.2. kur identifikohen pengesa që mund ta ndryshojnë performancën e funksionit të jashtë kontraktuar;
 - 1.3. kur ka ndryshime materiale që ndikojnë në marrëveshjen për kontraktim të jashtëm ose ofruesin e shërbimit (p.sh., nënkontraktimi i jashtëm ose ndryshimet e nënkontraktorëve të jashtëm);
 - 1.4. kur ka dobësi në lidhje me menaxhimin dhe sigurinë e të dhënave ose informacioneve konfidenciale, personale ose të ndjeshme; dhe
 - 1.5. kur jepen udhëzime nga BQK, p.sh., në rastin kur BQK, si rezultat i marrëveshjes për kontraktim të jashtëm, nuk është më në pozitë ta mbikëqyrë institucionin në mënyrë efektive.
2. Marrëveshja për kontraktim të jashtëm duhet ta lehtësojë transferimin e funksionit të jashtë kontraktuar tek një ofrues tjetër shërbimi ose ri-inkorporimin e tij në institucion. Për këtë qëllim, marrëveshja me shkrim për kontraktim të jashtëm duhet:

- 2.1. t'i përcaktojë qartë detyrimet e ofruesit ekzistues të shërbimit, në rastin e transferimit të funksionit të jashtë kontraktuar tek një ofrues tjetër shërbimi ose përsëri te institucioni, duke përfshirë trajtimin e të dhënave;
- 2.2. të caktojë një periudhë të përshtatshme kaluese, gjatë së cilës ofruesi i shërbimit, pas ndërprerjes së marrëveshjes për kontraktim të jashtëm, do të vazhdojë të ofrojë funksionin e jashtë kontraktuar për ta zvogëluar rrezikun e ndërprerjeve; dhe
- 2.3. të përfshijë detyrimin e ofruesit të shërbimit për ta mbështetur institucionin në transferimin e rregullt të funksionit në rast të ndërprerjes së marrëveshjes për kontraktim të jashtëm.

Neni 24

Mbikëqyrja e funksioneve të jashtë kontraktuara

1. Institucionet duhet të monitorojnë, në mënyrë të vazhdueshme, performancën e ofruesve të shërbimeve në lidhje me të gjitha marrëveshjet për kontraktim të jashtëm mbi një qasje të bazuar në rrezik dhe me fokusin kryesor në kontraktimin e jashtëm të funksioneve kritike ose të rëndësishme, duke përfshirë që disponueshmëria, integriteti dhe siguria e të dhënave dhe informacioneve të sigurohet. Kur rreziku, natyra ose shkalla e një funksioni të jashtë kontraktuar ka ndryshuar në aspektin material, institucionet duhet ta rivlerësojnë rëndësinë kritike ose rëndësinë e atij funksioni në përputhje me nenin 6 të kësaj Rregulloreje.
2. Institucionet duhet të aplikojnë aftësitë, kujdesin dhe masat parapake të duhura kur monitorojnë dhe menaxhojnë marrëveshjet për kontraktim të jashtëm.
3. Institucionet duhet ta përditësojnë rregullisht vlerësimin e tyre të rrezikut në përputhje me nenin 16 të kësaj Rregulloreje dhe duhet t'i raportojnë periodikisht organit menaxhues mbi rreziqet e identifikuar në lidhje me kontraktimin e jashtëm të funksioneve kritike ose të rëndësishme.
4. Institucionet duhet t'i monitorojnë dhe menaxhojnë rreziqet e tyre të brendshme të përqendrimit të shkaktuara nga marrëveshjet për kontraktim të jashtëm, duke marrë parasysh nenin 16 të kësaj Rregulloreje.
5. Institucionet duhet të sigurojnë, në mënyrë të vazhdueshme, që marrëveshjet për kontraktim të jashtëm, ku fokusi kryesor është në funksionet kritike ose të rëndësishme të jashtë kontraktuara, t'i përmbushin standardet e duhura të performancës dhe cilësisë në përputhje me politikat e tyre duke:
 - 5.1. siguruar që ata të marrin raportet e duhura nga ofruesit e shërbimeve;
 - 5.2. vlerësuar performancën e ofruesve të shërbimeve duke përdorur mjete të tilla si treguesit kyç të performancës, treguesit kyç të kontrollit, raportet e ofrimit të shërbimeve, vetë-certifikimi dhe rishikimet e pavarura; dhe
 - 5.3. shqyrtuar të gjitha informatat e tjera relevante të marra nga ofruesi i shërbimit, duke përfshirë raportet mbi masat e vazhdimësisë së biznesit dhe testimin.
6. Institucionet duhet të marrin masat e duhura nëse identifikojnë mangësi në ofrimin e funksionit të jashtë kontraktuar. Në veçanti, institucionet duhet të ndjekin çdo indikacion që ofruesit e shërbimeve mund të mos e kryejnë funksionin e jashtë kontraktuar kritik ose të rëndësishëm në mënyrë efektive ose në përputhje me ligjet në fuqi dhe kërkesat rregullatore. Nëse identifikohen mangësi, institucionet dhe institucionet e pagesave duhet të ndërmarrin veprimet e duhura korrektuese ose korrigjuese. Veprime të tilla mund të përfshijnë ndërprerjen e marrëveshjes për kontraktim të jashtëm, me efekt të menjëhershëm, nëse është e nevojshme.

Neni 25

Strategjitë e daljes

1. Për të siguruar performancë të vazhdueshme të funksioneve që i nënshtrohen kontraktimit të jashtëm, pa ndikim negativ në pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore dhe në cilësinë e ofrimit të shërbimeve për klientët, institucionet duhet të krijojnë, për të gjitha funksionet kritike dhe të rëndësishme të jashtë kontraktuara, një strategji të daljes të paktën në rast të:
 - 1.1. anulimit ose ndërprerjes së marrëveshjeve për kontraktim të jashtëm;
 - 1.2. dështimit të ofruesit të shërbimeve;
 - 1.3. përkeqësimit të cilësisë së funksionit të jashtë kontraktuar dhe çrregullimeve reale ose të mundshme të biznesit të shkaktuara nga ofrimi i papërshtatshëm ose i dështuar i shërbimeve që lidhen me funksionin e jashtë kontraktuar;
 - 1.4. rreziqeve materiale që lindin për zbatimin e duhur dhe të vazhdueshëm të funksionit të jashtë kontraktuar.
2. Institucionet duhet të sigurojnë që ato të jenë në gjendje t'i anulojnë ose ndërpresin marrëveshjet për kontraktim të jashtëm me ofruesit e shërbimeve pa ndërprerje të panevojshme në aktivitetet e saj të biznesit, pa kufizuar pajtueshmërinë e tyre me kërkesat rregullatore dhe pa asnjë dëm për vazhdimësinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve për klientët.
3. Për t'i përmbushur kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni, institucionet:
 - 3.1. zhvillojnë dhe zbatojnë plane të daljes që janë gjithëpërfshirëse, të dokumentuara dhe, sipas rastit, të testuara mjaftueshëm (p.sh., duke kryer një analizë të kostove të mundshme, ndikimeve, burimeve dhe implikimeve kohore të transferimit të një shërbimi të jashtë kontraktuar tek një ofrues alternativ); dhe
 - 3.2. identifikojnë zgjidhje alternative dhe zhvillojnë plane kaluese për t'i mundësuar institucionit t'i heqë funksionet e jashtë kontraktuara dhe të dhënat nga ofruesi i shërbimit dhe t'i transferojë ato tek ofruesit alternativë ose përsëri tek institucioni ose të marrë masa të tjera që sigurojnë ofrimin e vazhdueshëm të funksionit kritik ose të rëndësishëm ose aktivitetit biznesor në një mënyrë të kontrolluar dhe mjaftueshëm të testuar, duke marrë parasysh sfidat që mund të lindin për shkak të vendndodhjes së të dhënave dhe duke marrë masat e nevojshme për ta siguruar vazhdimësinë e biznesit gjatë fazës së kalimit.
4. Gjatë zhvillimit të strategjive të daljes, institucionet:
 - 4.1. përcaktojnë objektivat e strategjisë së daljes;
 - 4.2. kryejnë një analizë të ndikimit në biznes që është në përpjesëtim me rrezikun e funksioneve të jashtë kontraktuara, me qëllim identifikimin e burimeve njerëzore dhe financiare për zbatimin e planit të daljes dhe sa kohë do të merrte;
 - 4.3. caktojnë role, përgjegjësi dhe burime të mjaftueshme për t'i menaxhuar planet e daljes dhe tranzicionin e aktiviteteve;
 - 4.4. aty ku është e aplikueshme, përcaktojnë kriteret e suksesit për kalimin e funksioneve të jashtë kontraktuara dhe të dhënave; dhe
 - 4.5. përcaktojnë treguesit që do të përdoren për monitorimin e marrëveshjes për kontraktim të jashtëm me ofruesin e shërbimit, duke përfshirë treguesit e bazuar në nivele të papranueshme të shërbimit që duhet të nxisin daljen.

KAPITULLI V

DETYRIMI PËR MIRATIME PARAPRAKE

Neni 26

Miratime paraprake të kontraktimit të jashtëm të një funksioni kritik ose të rëndësishëm

1. Institucionet të cilat synojnë të kontraktojnë nga jashtë një funksion kritik ose të rëndësishëm siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj rregullore, brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se 30 ditë para se të hyjnë në marrëveshje me një ofrues shërbimi, e njoftojnë BQK-në për këtë dhe kërkojnë paraprakisht miratimet.
2. Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të përmbajë një shpjegim që përfshin përshkrimin e funksioneve kritike ose të rëndësishme që do të jashtë kontraktohen dhe arsyet për marrjen e vendimit për kontraktim të jashtëm.
3. Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni shoqërohet me informatat e përcaktuara në nenin 13, paragrafët 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje, të cilat do të përfshihen në regjistër pas lidhjes së marrëveshjes për kontraktim të jashtëm.
4. Kur një ofrues i shërbimit ka selinë e tij dhe/ose operon në vendet e treta, institucionet paraqesin dëshmi se rregulloret e një vendi ose vendeve në të cilat operon ofruesi i shërbimeve i mundësojnë BQK-së:
 - 4.1. t'i arrijë objektivat e mbikëqyrjes, për të kryer një inspektim në vendndodhje të një pjese të operimit të ofruesit të shërbimit që lidhet ose mund të lidhet me kontraktimin e jashtëm, si dhe një inspektim në vendndodhje të funksioneve që janë objekt i marrëveshjes; dhe
 - 4.2. të ketë qasje në kohë dhe të plotë në dokumentacionin dhe të dhënat në lidhje me kontraktimin e jashtëm të cilat janë në zotërim të ofruesit të shërbimit.
5. Përveç informatave të përcaktuara në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, BQK mund të kërkojë çdo informacion shtesë që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin nëse kushtet për kontraktim të jashtëm të përcaktuara në Ligjin për Bankat, Ligjin për Shërbimet e Pagesave dhe këtë Rregullore janë përmbushur.
6. Aprovimi paraprak i BQK-së sipas këtij neni jepet ose refuzohet brenda një periudhe prej dy muajsh nga data e dorëzimit të informatave përkatëse, duke përfshirë informatat përkatëse të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni.

KAPITULLI VI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Periudha kalimtare

1. Institucionet që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje i përshtatin plotësisht aktivitetet dhe operacionet e tyre, duke përfshirë marrëveshjet ekzistuese kontraktuale për kontraktim të jashtëm, me dispozitat e kësaj Rregulloreje brenda 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje të përcaktuar në nenin 30 të kësaj rregullore.

2. Të gjitha marrëveshjet për kontraktim të jashtëm të lidhura pas datës së specifikuar në nenin 30 të kësaj rregulloreje i nënshtrohen dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 28

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje i nënshtrohet masave korrigjuese dhe ndëshkimeve administrative, siç janë përcaktuar në neni 67 të Ligjit nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150, dhe nenin 125, paragrafi 2 nënparagrafët 2.8 dhe 2.9 Ligjit për Shërbimet e Pagesave.

Neni 29

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet kapitulli V i Rregullores për agjentë dhe nën kontraktimin e aktiviteteve të ofruesve të shërbimeve të pagesave e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 29.shtator 2019.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 shtator 2026.

Dr.sc. Bashkim Nurboja,

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës